

## Rezolutë:

# “Standardet e përgjithëshme të adoptuara nga Shefat e INTERPOL, për luftën ndaj korrupsionit”

*Marrë nga Revista “The Police Chief”, Janar 2003*

### **Subjekti: Adoptimi i standardeve të përgjithëshme për të luftuar korrupsionin në shërbimet dhe forcat policore**

Asambleja e Përgjithëshme e ICPO-Interpol, e mbledhur në Yaoundé nga 21 deri më 24 Tetor 2002, në sesionin e saj të 71<sup>të</sup>:

**DUKE RISHQYRTUAR** Rezolutën Nr. AG- 2001-RES-04 të adoptuar nga Asambleja e Përgjithëshme në Sesionin e saj të 70<sup>të</sup> (Budapest, Shtator 2001),

**E BINDUR** se korrupsioni minon efektivitetin e zbatimit të ligjit, efikasitetin dhe legjitimitetin e shërbimeve/ forcave policore në përmbushjen e funksioneve të tyre dhe besimin e publikut në zbatimin e ligjit dhe tek drejtësia,

**DUKE QENË AKOMA ME TEJ TE BINDUR** se korrupsioni brenda forcave/shërbimeve policore mund të parandalohet dhe të eliminohet përmes veprimeve të vendosura dhe të rrepta kombëtare nga të gjithë shtetet anëtare dhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar,

**DUKE VLËRESUAR** se policimi efektiv kërkon të luftohen të gjitha format e korrupsionit në përmbushjen e funksioneve të policimit dhe të promovimit të standardeve të larta të ndershmërisë, integritetit dhe sjelljeve etike nga të gjithë punonjësit e policisë dhe punonjësit e tjerë të forcave/shërbimeve policore,

**TË BINDUR PËRFUNDIMISHT** se përpjekjet e vendosuar për të luftuar korrupsionin dhe për të promovuar standardet e larta të ndershmërisë, integritetit dhe sjelljeve etike, rrisin efikasitetin dhe efektivitetin e forcave/shërbimeve policore dhe përmirësojnë mbështetjen e përkrahjen e zbatimit të ligjit nga shoqëria civile,

**SËRISH TË BINDUR** se policimi do të jetë efektiv vetëm kur ai përfshihet e vlerësohet brenda sistemit të drejtësisë penale, i lidhur ngushtë me prokurorët, gjykatësit dhe avokatë, që gjithashtu kanë standarde të larta të ndershmërisë, integritetit dhe të sjelljeve etike dhe që janë të vendosur të qëndrojnë në lidhje të ngushtë të gjithë të tjerëve që përfshihen brenda këtij sistemi,

**DUKE NJOHUR** nevojën për t'i bërë të gjithë qytetarët e shteteve anëtare të vetdijshëm për pasojat shkatërruese të korrupsionit ndaj ligjit dhe rendit, sigurisë publike dhe private, mbrojtjes së pronës dhe kostos së zbatimit të ligjit,

**DUKE NJOHUR GJITHASHTU** përgjegjësitë e shteteve anëtare për të zbuluar dhe vënë para përgjegjësisë ligjore, disiplinore e morale punonjësit e korruptuar të policisë dhe punonjësit e tjerë në forcat/shërbimet policore,

**TË VENDOSUR** për të ndërmarrë veprime energjike për të parandaluar, zbuluar, ndëshkuar dhe çrrënjësuar korrupsionin në, dhe në lidhje me, përmbushjen e funksioneve të policimit dhe për të nxitur e përkrahur çdo përqafim të standardeve të larta të ndershmërisë, integritetit dhe sjelljes etike në forcat/shërbimet policore të çdo vendi anëtar,

**DUKE PRANUAR** se çdo parim dhe pamsë që përfshihet në termin “Standarde” janë gjykuar si të një rëndësie të mjaftueshme në luftën kundër korrupsionit për tu përfshirë në këtë dokument nga grupi i ekspërtëve të Interpolit,

**DUKE MARRË NË KONSIDERATË** faktin se leximi si një i tërë i dokumentit përfaqëson një ideal etik, të cilin shtetet anëtare duhet të synojnë ta arrijnë, kurse implementimi i secilit nga parimet e paraqitura, përbën një hap në drejtimin e duhur,

**ARRITËM MARRËVESHJEN** për të adoptuar *“Standardet e Përgjithëshme për luftën kundër korrupsionit në forcat e shërbimet e policisë”*, që i bashkëngjiten Raportit No. 10, si standarde për t’u ratifikuar e implementuar nga të gjitha policitë, që do të përmirësojë cilësinë e policisë dhe kualitetet e shërbimeve që kryen ajo kudo. Vendet anëtare për pasojë inkurajohen t’i përhapin dhe propagandojnë këto standarde sa të jetë e mundur më shumë në forcat e shërbimet e tyre.

**Adopton:**  
**Standardet e përgjithëshme për luftën kundër  
korrupsionit në forcat dhe shërbimet e policisë**

***Neni 1***

**Objektivat**

- Të garantohet që forcat dhe shërbimet e policisë të çdo shteti anëtar i Interpolit të ketë standarde të larta të ndershmërisë, integritetit dhe sjelljes etike tek punonjësit dhe në lidhje me ta në përmbushjen e funksioneve të tyre të policimit.
- Të nxitet dhe të forcohen nga çdo shtet anëtar i Interpolit, masat e nevojshme për të parandaluar, zbuluar, ndëshkuar dhe çrrënjësuar korrupsionin në forcat dhe shërbimet e policisë brenda territorit të tyre dhe të cojnë para drejtësisë punonjësit e policisë dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të policisë që janë të korruptuar.

***Neni 2***

**Përkufizime**

Korrupsion do të thotë:

- Të kërkuarit ose të pranuarit, direkt ose indirekt, nga punonjësit e policisë ose nëpunësit e të policisë i pareve, artikujve më vlerë, dhuratave, favoreve, premtimeve, shpërblimeve ose avantazheve, për vete ose për çdo person, grup apo entitet tjetër shoqëror, në këmbim të ndonjë veprimi ose lëshimi të kryer, ose të toleruar, ose që do të kryhet ose tolerohet në të ardhmen gjatë ose në lidhje me përmbushjen e çdo funksioni që ka të bëjë me policimin.
- Ofrimi ose dhurimi, direkt ose indirekt, ndaj një punonjësi ose nëpunësi tjetër të policisë i vlerave monetare, artikujve me vlerë, dhuratave, favoreve, premtimeve, shpërblimeve ose avantazheve për veten e tyre ose për çdo person, grup apo entitet në këmbim të veprimit ose mosveprimit të kryer ose që do të kryhet në të ardhmen gjatë ose në lidhje me përmbushjen e funksioneve të tyre të policimit.
- Çdo akt ose lëshim gjatë kryerjes së detyrave nga punonjësit e policisë apo çdo nëpunës tjetër i policisë, që mund ta ekspozojë një person ndaj akuzës ose fajësisë për një shkelje penale ose që mund ta ndihmojë një person për të mos u ngarkuar ose që e shfajson në mënyrë të padrejtë nga një shkelje penale.
- Përhapja ose bërja publike në mënyrë të paautorizuar i informacioneve konfidenciale ose të ndaluara të policisë për të marrë shpërblime ose çdo gjë tjetër të ngjashme.
- Çdo veprim ose mosveprim që kryhet gjatë kryerjes së detyrave nga punonjësit e policisë ose çdo nëpunës tjetër i policisë për qëllime të përvetësimit të parave, artikujve me vlerë, dhuratave,

favoreve, premtimeve ose avantazheve për vete ose për persona, grupe ose entitete të tjera shoqërore.

- Çdo veprim ose mosveprim që përbën korrupsion sipas ligjeve të një shteti anëtar.
- Pjesëmarrja si fajtor kryesor, si bashkëfajtor kryesor, inisiator, nxitës, bashkëfajtor, pjesmarrës para dhe pas faktit, fshehës ose çdo mënyrë tjetër e pjesmarrjes direkte apo indirekte, aktiv ose inaktiv në kryerjen ose përgatitjen e çdo veprimi që konsiderohet korrupsion si më sipër këtij neni.
- “Forcë/ shërbim policor” nënkuptohet çdo forcë policie, çdo shërbim policie ose çdo organizim tjetër zyrtar që ka përgjegjësinë të përbushë funksione të policimit brenda kufijve të një shteti anëtar.

### ***Neni 3***

#### **Parimet**

- Të konsiderohet korrupsioni, brenda forcave/shërbimeve policore, një krim me rrezikshmëri të lartë.
- Të nxitet dhe të mbahet një standart i lartë i ndershmerisë, integritetit dhe sjelljes etike në forcat/shërbimet e policisë të çdo shteti anëtar.
- Të shtohet kujdesi për rekrutimin dhe trainimin në mënyrë që të pranohen dhe edukohen si punonjës të policisë persona me nivele të larta të integritetit, ndeshmerisë, stadardeve etike dhe ekspertizës profesionale.

### ***Neni 4***

#### **Masat**

Çdo anëtar i Assamblesë së përgjithëshme i beson dhe respekton Standardet e Sjelljes:

- 4.1 Vendorsja dhe mbajtja e standardeve të larta të sjelljes për ndershmeri, përbushje efektive dhe etike të funksioneve policore.

4.1.1 Këto standarde duhet të mandatohen dhe të orientohen drejt kuptimit dhe aplikimit të sjelljes së ndershme, etike dhe të përshtatshme, për të shmangur konfliktet e interesave, për të përdorur me korrektësi burimet publike në dhe në lidhje me aplikimin e drejtë, të paanshëm dhe të barabartë të ligjit, me përbushjen e funksioneve të policimit, për të raportuar aktet e korrupsionit gjatë këtyre funksioneve dhe për të vendosur e forcuar mirëbesimin e publikut për punonjësit e policisë dhe forcat e shërbimeve të policisë si pjesë e sistemit të drejtësië.

4.1.2 Këto standarde duhet të pranohen si obligim i forcës/shërbimit policor për të mënjanuar dhe për të trajtuar me efektivitet korrupsionin brenga radhëve të forcave dhe shërbimeve policore.

Standarde të tilla duhet të imponohen si detyrim për punonjësit e policisë dhe punonjësit e tjerë të forcave e shërbimeve policore për të raportuar tek personat e përshtatshëm ose autoritetet, veprimet ose omissions, që përbëjnë e përfshihen ose mund të përbëjnë veprime korrupsioni brenda radhëve të policisë.

- 4.2 Ndërtimi dhe mbajtja në pozite efektiviteti i mekanizmave të parandalimit, vëzhgimit dhe shtrëngimit të standardeve të larta të sjelljes, jo vetëm është e domosdoshme, por edhe të jetë në përputhje me përbushjen e funksioneve policore; të rekrutimit, caktimit në poste, gradimit dhe daljes në pension.

- 4.3 Ndërtimi dhe mbajtja në pozita efektive e sistemeve të rekrutimit për të pranuar punonjës policie me nivele të larta të ndershmërisë, dinjitetit, standardeve etike dhe ekspërtizës;
- 4.4 Krijimi i garancive që sistemet e rekrutimit, të caktimit nëpër poste, gradimit dhe and termination të punonjësve të policisë dhe punonjësve të tjerë të forcave dhe shërbimeve policore të mos jenë arbitrare, por të bazohen tek paanshmëria e barabartësia, transparencja e çiltërsia, tek aftësitë personale dhe tek rezultatet e arritura;

### **Trainimi**

- 4.5 Vendosja e një sistemi të instruktimit të punonjësve të policisë dhe të tjerëve të angazhuar në (dhe që lidhen me) përmbushjen e funksioneve të policimit, me standardet dhe rregullat etike të aplikueshme për të përmbushur këto funksione;

Vendosja dhe mirëmbajtja e një sistemi trainimi, duke përfshirë edhe trainimin e vazhdueshëm, të punonjësve të policisë dhe punonjësve të tjerë në forcat/shërbimet e policisë, që do të përmirësojë e përforcojë standardet e larta të sjelljes, sikurse përmenden më lart në Nenin 4.1;

### **Korrupsioni**

- 4.6 Vendosje e pengesave për ata që përfshihen në mitëmarrje gjatë, ose në lidhje me përmbushjen e funksioneve të policimit;
- 4.7 Përdorim i përpjekjeve më të mira për të garantuar që mekanizmat dhe sistemet e parandalimit, zbulimit, ndëshkimit dhe çrrënjësjes së korrupsionit në dhe në lidhje me përmbushjen e funksioneve të policimit në forcat dhe shërbimet e tij, të jenë në të njëjtën kahje me praktikatat e aktuale të pranuar nga Asambleja e Përgjithëshme e Interpolit;
- 4.8 Pasje e një sistemi që obligon punonjësit e policisë dhe të tjerë punonjës në forcat dhe shërbimet e policisë të raportojnë, të mundësojnë pjestarët e shoqërisë civile për të raportuar rreth korrupsionit si dhe të mbrojnë ata që raportojnë korrupsionin në mirëbesim;
- 4.9 Ndërtim dhe vendosje e mekanizmave që inkurajojnë pjesmarrjen e shoqërisë civile në veprimtaritë dhe përpjekjet për të parandaluar korrupsionin në forcat dhe shërbimet e policisë;
- 4.10 Ndërtimi, vendosja dhe zbatimi i procedurave për deklarimin dhe regjistrimin e të ardhurave, asetëve dhe detyrimeve të atyre që kryejnë funksione policimi dhe pjestarëve të afërt të famijeve të tyre;

### **Sistemet**

- 4.11 Vendosja dhe mirëmbajtja e sistemeve të menaxhimit të grumbullimit të të ardhurave, fondeve e pasurive; të kontrollit dhe ruajtjes së të dhënave, të tilla që të garantojnë se ata që i mbledhin ose i menaxhojnë fondet publike; që merren me evidentimin e tyre ose që mbarështrajnë pasuritë, të jenë llogaridhënës e të lexueshëm. Këto sisteme të jenë të tillë që të mund të zbulojnë korrupsionin;
- 4.12 Vendosja dhe mirëmbajtja e sistemeve për prokurimet e të mirave dhe shërbimeve që janë të bazuara tek transparencja, efiçenca, barabartësia dhe qartësia e rregullave që aplikohen dhe që kërkojnë vlerën më të mirë të këtyre fondeve;

### **Monitorimi**

- 4.13 Ndërtimi dhe vendosja e mekanizmave të tillë si bordet ose grupet për të monitoruar sistemet dhe masat e përcaktuara për parandalimin, zbulimin, ndëshkimin dhe çrrënjësjen e korrupsionit brenda forcave dhe shërbimeve të policisë, si dhe efikasitetin aplikimin dhe efektivitetin e këtyre sistemeve dhe masave;

- 4.14 Akordimi ose dhënia e kompetencave një autoriteti të caktuar për këtë qëllim, të brendshëm ose të jashtëm, i pushtetit të nevojshëm për të zhvilluar hetime dhe vënë para drejtësisë pa druajtje ose favore, pa afeksion ose vullnet të keq të atyre që përfshihen në korrupsion dhe sjellje të pandershme gjatë ose në lidhje me kryerjen e detyrave dhe funksioneve të policimit, si dhe kompletimi me burime dhe mjete financiare të mjaftueshëm të këtij autoriteti;
- 4.15 Garantimi i një sistemi të rekrutimit për punonjësit e këtij autoriteti që të kenë një shkallë të lartë integriteti dhe që të garantojë se këta punonjës e zyrtarë nuk do të kenë disavantazhe për shkak të rekrutimit të një autoritet të tillë;
- Parashikim i masave të përshtatshme të sigurimit që do të parandalonin abuzimin me pushtetin prej atyre që angazhohen me punë pranë sistemit të anti-korrupsionit dhe që do të minimizonin çënimet dhe shkeljet e panevojshme të të drejtave të individit;

### **Shqyrtimi, raportimi dhe kërkimi**

- 4.11 Kërkohet raportim në publik së paku një herë në vit i punës së bërë dhe rezultateve nga monitorimi i sistemeve dhe masave që i referohen Nenit 4.14 mbi përshtatshmërinë, zbatueshmërinë dhe efektivitetin e tyre;
- 4.12 Vazhdim i kërkimit shkencor në lidhje me evidentimin e praktikave aktuale më të mira për parandalimin, zbulimin, ndëshkimin dhe çrrënjosjen e korrupsionit në dhe në lidhje me përmbushjen e funksioneve të policimit;
- Shqyrtimi dhe analiza në intervale të përshtatshme dhe të rregullta i masave dhe sistemeve të parandalimit, zbulimit, ndëshkimit dhe çrrënjosjes së korrupsionit gjatë dhe në lidhje me performacën e funksioneve të policimit;

### **Të përgjithshme**

- 4.11 Korrupsioni i një punonjësi policie ose çdo punonjësi tjetër në forcat dhe shërbimet policore duhet të konsiderohet si një shkelje shumë serioze kriminale;
- 4.12 Të hartohet dhe aktivizohet një legjislacion që lejon të procedohet ndaj korrupsionit dhe krimeve që lidhen me të, për t'i ndëshkuar me konfiskim;
- 4.13 Të vihen në jetë ose të bëhen përpjekje për të influencuar që të merren masa legjislative, administrative dhe të tjera të domosdoshme për të parandaluar, zbuluar, ndëshkuar dhe çrrënjosur korrupsionin nga forcat dhe shërbimet e policisë;
- Të ndërmeren të gjitha hapat konkretë e praktikë për të garantuar realisht, që masa dhe koeficientët e shpërblimit të punonjësve të policisë dhe punonjësve të tjerë në forcat dhe shërbimet e policisë, t'iu mundësojë, atyre dhe familjeve të tyre që të mbajnë një standard të arsyeshëm jetese, pa pasur nevojë t'i drejtohen burimeve të tjera të punësimit ose korrupsionit;

### **Asambleja e Përgjithshme**

- 4.14 Të raportohet së paku një herë në dy vjet, ose në intervale me të shkurtëra, nëse vendos Asambleja e Përgjithshme, mbi masat e marra për mekanizmat dhe sistemet e implemenetimit të standardeve të parashtruara në këtë protokoll, si dhe mbi efektivitetin e këtyre mekanizmave, masave dhe sistemeve;
- 4.15 Të lejohet monitorimi nga, dhe koopërimi me, personin/personat që mund të ngarkohen nga Sekretari i Përgjithshëm për të monitoruar mekanizmat, sistemet dhe masat nëpër vendet anëtare, lidhur me arritjen e objektivave dhe plotësimin e standardeve dhe efektivitetin që i referohen këtij protokoll nga forcat dhe shërbimet respektive të policisë.

## ***Neni 5***

### **Shqyrtimi**

Veprimi i këtij protokolli do të shqyrtohet nga Sekretariati i Përgjithëshëm i Interpol-it në baza të vazhdueshme dhe do të jetë subjekt i raportit në çdo sesion të Asamblesë së Përgjithëshme që do të mbahet pas përfundimit të një periudhë prej dy vjetësh, nga data e adoptimit të këtij protokolli.